

3.




Aftësi për Punë / Skills for Jobs

SI PO FUNKSIONON MËSIMI NË DISTANCË?

TETOR 2020



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

Në partneritet me:



Zbatuar nga:



UDHËZUES PËR PLANIFIKIMIN E MËSIMIT NË SHKOLLAT PROFESIONALE

Tetor 2020

Ky publikim është prodhuar nga projekti “Aftësi për Punë” (S4J). Materiali u përgatit nga Migena Kapllanaj dhe Bernard Zeneli, konsulentë të projektit, nën mbikqyrjen e Erka Çaro, Zv. Menaxhere e projektit S4J dhe Koordinatore Komponenti për Mënyrat e Reja të të Nxënit.

Rreth projektit “Aftësi për Punë”

“Aftësi për Punë” (S4J) është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), i cili zbatohet në Shqipëri nga organizata Swisscontact.

S4J adreson sfidat kryesore në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) në Shqipëri duke investuar për sigurimin e ndryshimeve sistematike, zhvillimin e kompetencave dhe fuqizimin e aktorëve. S4J mbështet ofruesit partnerë të AFP-së në drejtim të krijimit të lidhjeve të ngushta me kompanitë e sektorit privat dhe partnerë të tjerë, diversifikimit dhe përmirësimit të ofertës mësimore, aplikimit të metodave të reja të mësimdhënies dhe standardeve të cilësisë, realizimit të praktikave mësimore në mjediset e biznesit dhe zhvillimit e fuqizimit të institucionit.

Shënim: Pikëpamjet dhe konkluzionet e shprehura në këtë publikim nuk paraqesin domosdoshmërisht ato të Qeverisë Zvicerane ose Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Autorësia e këtij publikimi i përket projektit “Aftësi për Punë” (S4J). Ndalohet riprodhimi dhe shpërndarja e publikimit pa miratim paraprak me shkrim nga S4J.

AFTËSI PËR PUNË S4J

Rruga Skënderbej, Vila nr. 49

Tiranë, Shqipëri, Kutia Postare 2891

Tel: +355 42 231 850

e-mail: al.info@swisscontact.org

www.aftesiperpune.al

Tabela e përmbajtjes

I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
II.	HYRJE DHE SFONDI SOCIO-POLITIK I AFP GJATË PANDEMISË.....	6
III.	KONTEKSTI DHE AKTORËT POLITIKËBËRËS.....	8
IV.	ANALIZA E GJETJEVE	10
A.	ANALIZË SITUACIONALE E AFP-SË PAS EFEKTEVE TË MËSIMIT NË DISTANCË.....	10
B.	ANALIZË SITUACIONALE NË 10 SHKOLLA AFP, PARTNERE TË PROJEKTIT S4J	11
C.	ANALIZË SITUACIONALE BAZUAR NË PIKËPAMJET E DREJTUESVE TË SHKOLLAVE DHE PËRFAQËSUESVE TË INSTITUCIONEVE DREJTUESE	15
V.	KONKLUZIONE	25
VI.	REKOMANDIME	29

I. Përmbledhje ekzekutive

Ky është studimi i tretë realizuar nga projekti S4J për mësimdhënien në distancë online zhvilluar gjatë pandemisë në 9 shkollat partnere të projektit. Qëllimi kryesor i këtij punimi është të sjellë së bashku përvojën e shkollave partnere të projektit në mësimdhënie gjatë periudhës së pandemisë dhe masat e nevojshme për ecurinë e procesit mësimor në distancë online. Zhvillimi i mëimit në distancë online gjatë pandemisë nxori në pah problematikat e realizimit të mëimit, pasojat e reformave të prapambetura, por njëkohësisht vullnetin dhe punën e madhe të mësuesve dhe nxënësve për të bërë më të mirën në kushtet ekzistuese. Mbase një nga konkluzionet më pozitive të mëimit gjatë pandemisë ishte pikërisht fakti që integrimi i teknologjisë së informacionit në procesin mësimor është një domosdoshmëri për të përshtatur procesin me kërkesat e tregut dhe me nevojat e nxënësve.

Metodologjia

Për përgatitjen e raportit u realizuan intervista me drejtuesit e nëntë shkollave partnere të projektit, me përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, dhe drejtuesen e Agjencisë Kombëtare të Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK). U kontaktuan për t'u intervistuar edhe përfaqësues të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA) por nuk u arrit të realizoheshin intervistat.

Gjithashtu për të analizuar situatën e shkollave janë përdorur edhe gjetjet nga studimet e mëparshme të realizuara nga S4J me mësuesit dhe nxënësit gjatë periudhës së pandemisë.

Rezultatet

Të dhënat tregojnë në mënyrë konsistente që mungon infrastruktura e nevojshme e të gjitha shkollave për mësimdhënien në distancë online. Edhe në rastin e shkollave ku është investuar nga projekti SKJ investimet janë bërë me qëllim përmirësimin e teknologjisë së shkollës por në kushtet e mësimdhënies ballë për ballë. Mësuesit dhe nxënësit kanë nevojë për akses në pajisje dhe në internet për të bërë të mundur mësimdhënien në distancë online.

Mësuesit dhe nxënësit janë përpjekur të bëjnë më të mirën për të përballuar mësimdhënien në distancë online. Bashkëpunimi mes mësuesve dhe ndërgjegjia e dashamirësia e mësuesve ishte një nga konstatimet e përbashkëta në të gjitha intervistat e realizuara. Megjithatë kjo nuk është e mjaftueshme për zhvillimin e një procesi mësimor efektiv. Përcaktimi i kriterëve minimale për realizimin e mëimit dhe mungesa e orientimeve të qarta e lë realizimin e mëimit në dashamirësinë e mësuesve, kur në fakt garanti për cilësinë nuk duhet të jetë individi por sistemi.

Nga të gjitha intervistat e realizuara por edhe nga studimet e mëparshme nga S4J del në pah nevoja e materialeve të përshtatshme mësimore për mësimdhënien në distancë online. Në arsimin profesional nevoja për materiale mësimore nuk është një çështje e re. veçanërisht

për modulet e formimit profesional mësuesit e kanë të vështirë të gjejnë materiale të mjaftueshme të përditësuara në gjuhën shqipe. Ky problem bëhet edhe më i madh në kushtet e mësimit online.

Trajnimi i mësuesve ishte një tjetër emërues i përbashkët i të gjitha intervistave dhe gjetjeve nga studimet e mëparshme. Trajtimi i mësuesve për mësimit online sinkron dhe asinkron, lidhur me teknikat e mësimit efektive në modalitete të ndryshme, vlerësimi i nxënësve në mësimit online etj.

Fuqizimi i platformës Mësoret, si një nga platformat e dedikuara ndaj Arsimit profesional. Hapja e moduleve të reja në platformë, hedhja e materialeve mësimore, trajnimi i mësuesve dhe nxënësve për përdorimin e platformës janë disa nga zhvillimet e nevojshme për përdorimin më të gjerë të platformës.

Praktika profesionale si aktiviteti më i rëndësishëm i arsimit profesional ka nevojë për vëmendje të veçantë. Mësuesit kishin gjetur mënyra kreative për të realizuar orët e praktikës profesionale në kushtet e pandemisë, por sipas drejtuesve të shkollave realizimi i praktikave profesionale ka pasur problematika edhe përpara fillimit të pandemisë. Zgjerimi i rrjetit të bashkëpunëtorëve, hartimi i rregulloreve dhe procedurave të realizimit të orëve të praktikës, trajnimi i vazhdueshëm i mësuesve të praktikës profesionale janë disa nga hapat që duhen ndërmarrë për të përmirësuar mënyrën e ofrimit të praktikës profesionale.

II. Hyrje dhe sfondi socio-politik i AFP gjatë pandemisë

Ky dokument vjen në vazhdimësi të studimeve që u ndërmorën nga projekti “Aftësi për Punësim” (S4J) gjatë kohës së izolimit dhe gjendjes së jashtëzakonshme prej pandemisë COVID-19, dhe që kishin në fokus bërjen e mësimit nga distanca në 9 shkolla profesionale me të cilat projekti ka partneritet. Ndërsa dy studimet e para u bazuan më së shumti në analizën e të dhënave nga sondazhet dhe intervistat me grupe të fokusuara, në këtë rast baza analitike janë intervistat e thelluara me drejtorët e shkollave, drejtues të arsimit profesional në nivele qendrore të qeverisjes si edhe në hulumtimin e raporteve dhe studimeve nga vende të tjera.

Qëllimi kryesor i këtij procesi vazhdon të jetë të mësuarit përmes analizës së situatës së mësimit nga distanca dhe nxjerrjes së mësimëve për të informuar sa më mirë bërjen e politikave efektive në arsimin dhe formimin profesional (AFP), të cilat përputhin arritjen e rezultateve shkollore dhe profesionale me efektivitetin e organizimit të procesit mësimor në situatën e kufizimeve nga pandemia. Efektiviteti sfidohet nga fakti se njohuritë shkencore dhe shëndetësore rreth COVID-19 janë në zhvillim e sipër të mbushura me pohime shpesh kundërshtuese të njëra tjetrës. Politikë-bërësit përfshi edhe ata në arsim vepruan nën presionin e madh dhe urgjencën e situatës ku duheshin marrë vendime, shpesh përballë argumenteve konkurruese dhe me shumë të panjohura. Hendeqet në njohuritë për këtë pandemi dhe me përballimin e situatave pandemike kanë bërë që vendimet e marra në një moment specifik mund të kenë nevojë të rishikohen pasi mësohet dhe kuptohet më mirë ky virus.

Në muajin qershor të këtij viti, u bë hapje e kufizuar e shkollave për maturantët. Kjo hapje u shoqërua me përpjekje për të rritur distancimin shoqëror dhe për të zvogëluar ndërveprimin mes nxënësve të cilat përfshinë: mbylljen e terrave të lojërave, rritjen e hapësirës midis nxënësve në klasë dhe shkurtimin e orëve të mësimit. Gjatë periudhës së verës shkollat u dezinfektuan dhe u marrën masa të thjeshta fizike për ventilim maksimal të klasave dhe mjediseve të tjera shkollore për të rritur nivelin e sigurisë shëndetësore. Këto masa fizike të shoqëruara dhe me lehtësime akademike në lidhje me materialin mësimor të mbuluar gjatë mësimit nga distanca dhe on-line, rezultuan në një mbyllje normale të vitit akademik dhe realizimin e provimeve të maturës si edhe të provimeve profesionale për nivelet e tjera në AFP. Edhe pse në kushte të vështira, si rezultat i tërmeteve të vitit 2019¹ dhe mbylljes së shkollave prej pandemisë, arsimi profesional arriti të sigurojë vazhdimësinë e elementeve kryesore bazuar edhe në vendimet dhe rekomandimet e ministrive përgjegjëse për arsimin.

Në radhë të parë u ruajt autonomia e shkollave të arsimit profesional dhe ishin ato që vendosën modelet e tyre si për të vlerësuar dijen ashtu edhe për të matur përparimin e nxënësve gjatë periudhës së karantimit. Vendimi i marrë për të mos përfshirë në vlerësimin

¹ Mësimi u ndërpre disa here përpara mbylljes së shkollave gjatë vitit shkollor 2019 – 2020 për shkak të tërmeteve në muajt shtator dhe nëntor të vitit 2019. Shkolla si ajo e Hoteleri Turizmit në Tiranë dhe shkolla “H Çela” në Durrës pësuan edhe dëme strukturore në ndërtesa. Kjo e fundit, shkolla “Hysen Çela” është në proces rindërtimi të plotë me fondet e BE në kuadër të projektit “EU 4 Schools”.

përfundimtar të nxënësve rezultatet e shënuara gjatë kësaj periudhe, edhe pse në pikëpamjen e barazisë në arsim i drejtë, cenoi reputacionin dhe autonominë e shkollave që patën punuar shumë gjatë arsimit në distancë siç ishte rasti i 9 shkollave të përfshira në projektin S4J. Së dyti, u ruajtën kërkesat kryesore kurrikulare të lidhura me planet mësimore të tremujorit përkatës edhe pse vlerësimi mbeti në nivele minimale. Së treti, u siguria një mirëkuptim mbarëshoqëror që fillimi i vitit të ri akademik 2020-21, t'i paraprijë një periudhë përforcuese për njohuritë e marra gjatë kryerjes së mësimit nga distanca si edhe përforcim i atyre njohurive gjatë vitit shkollor në vazhdim. Së katërti, u ruaj vazhdimësia e praktikës profesionale, sfida më e madhe gjatë kohës së izolimit kur u mbyllën edhe bizneset, dhe praktika vazhdoi në kushtet e shtëpisë.

Për të ndihmuar në procesin e bërjes së politikave sa më efektive veçanërisht në lidhje me arsimin profesional vlerësimi i asaj që ndodhi gjatë karantimit dhe gjendjes së jashtëzakonshme do të nxjerrë në pah problematikën që lidhet me zhvillimin e proceseve mësimore në kontekstin e ri pas karantinës dhe me kufizime të shumta të jetës social-ekonomike. Kthimi i shkollave dhe procesit të mësimit në rrugën e duhur është bërë qëllim kryesor tashmë bazuar në:

- Vlerësimin i progresit gjatë mësimit në distancë dhe online bazuar në një vlerësim të situatës akademike dhe psiko-emocionale të nxënësve për të ndihmuar në planifikimin dhe organizimin e mësimit të tyre.
- Zbutjen e ndikimit të humbjeve në mësim për shkak të nivele të ndryshme të angazhimit në mësimin në distancë apo online. Situata social ekonomike e krijuar pas heqjes së gjendjes së jashtëzakonshme është e vështirë. Kjo e kombinuar me prapambetjen që mund të kenë krijuar nxënësit rrit rrezikun e lënies së shkollës.
- Sigurimin e mirëqenies emocionale për nxënësit të cilët gjatë periudhës së karantinës mund të kenë pasur shqetësime emocionale nga pandemia, duke filluar nga ankthi deri tek simptomat e stresit. Përparësi në vitin e ri akademik është edhe rikthimi i “jetës normale” duke mbështetur si shëndetin mendor dhe atë fizik të nxënësve.
- Stabilitetin në arsim duke u kujdesur për aspektet emocionale të mësuesve dhe familjeve të tyre të cilat në shumë raste kanë përballuar dyfishin e stresit dhe që ende luftojnë me stresin e akumuluar (manipulim i roleve dhe detyrave të shumta, shqetësimet financiare dhe shëndetësore, etj.)

III. Konteksti dhe aktorët politikëbërës

Ekosistemi i arsimit profesional në kushtet e mësimdhënies në distancë ndryshoi bazuar në ndryshimet që pësuan si procesi mësimor ashtu edhe marrëdhëniet e palëve të përfshira në këtë proces. Ndërsa qëllimi i AFP, mbeti i njëjtë, aftësim dhe përforcim aftësish profesionale, format që aftësimi mori ndryshuan duke u përpjekur për të realizuar edhe qëllime po aq të rëndësishme sa kryesori siç ishin angazhimi i nxënësve, dhe deri diku edhe sigurimi i kushteve edhe për ata që nuk kishin mundësi për të ndjekur mësimin nga distanca, dhe zhvillimin e praktikave profesionale në kushtet e distancës.

Infrastruktura provoi të ishte një pengesë kryesore për të mësuarin digjital efektiv. Shkollat dhe sistemet arsimore që ishin angazhuar më herët në ofrimin e trajnimeve për metoda digjitale të mësimdhënies dhe që kishin bërë investime infrastrukturore si në rastin e disa prej shkollave të projektit S4J e patën më të lehtë adaptimin me kushtet e mësimin në distancë dhe on-line. Investimet në TIK dhe trajnimin e mësuesve me metodat e mësimin në distancë dhe digjital janë tashmë një përparësi për çdo nivel të politikë-bërjes duke u fokusuar te grupet më në nevojë që janë edhe më të ekspozuarat ndaj mungesave infrastrukturore dhe lidhjes me internet. Këtu duhet të kemi parasysh që mungesa e internetit është shoqëruar me mungesën e energjisë elektrike dhe shtrenjtësinë e qasjes në internet në zonat rurale dhe malore për shkak të mungesës së investimeve në rrjete dhe marrjes së shërbimit të internetit përmes telefonisë celulare. Ajo që duhet evituar është krijimi i një forme të re të pabarazisë në arsim bazuar në infrastrukturë.

Bazuar në udhëzimin e MASR dhe urdhrin nr. 826 të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA) secila shkollë profesionale hartoi një plan pune për mësimin në distancë me ndarje detyrash dhe organizimin e ofrimit të mësimin në distancë duke përdorur teknologji digjitale të komunikimit kryesisht të bazuara në aplikacionin “Whatsapp”. Urdhrat e brendshëm të drejtorive të shkollave rekomanduan koordinimin e punës përmes organizimit të grupeve të komunikimit në këtë aplikacion. Grupet u ndërtuan nga mësuesit kujdestarë të cilët përcaktuan edhe formën e komunikimit për të mundësuar hapat e mëtejshëm të zhvillimit të lëndëve bazuar në orarin zyrtar të mësimin². Procesi i diktuar me nxitim e në kushtet e emergjencës pandemike, gjatë muajit prill 2020, pësoi ndryshime në përshtatje me situatën e diktuar dhe në përputhje me procesin mësimor nga distanca. Ai u orientua më shumë drejt platformave digjitale të mësimdhënies duke pasur për bazë komunikimin në grup përmes rrjetin social WhatsApp.

Duket të jetë mjaft e vështirë, dhe në disa raste joreale, të kesh një tranzicion të shpejtë nga të mësuarit ballë për ballë në mësimin në distancë e me internet siç ndodhi gjatë izolimit prej pandemisë dhe vazhdimin të mësimin në distancë gjatë gjendjes së jashtëzakonshme. Proceset

² Informacioni mbi të cilin është ndërtuar ky seksion bazohet mbi të dhënat e mbledhura nëpër shkollat që janë pjesë e projektit “S4J” dhe pasqyron hapat që janë ndërmarrë nëpër shkolla për të krijuar mundësi për vijueshmërinë e procesit mësimor në distancë duke përdorur teknologjitë digjitale.

e menaxhimit të arsimit si planifikimi, përgatitja, adaptimi i kujdesshëm dhe krijimi i një hapësirë e përshtatshme për të mësuar u testuan fort gjatë kësaj situatë dhe arritën të mbijetojnë. Viti i ri shkollor shton presionin për të përballuar si mësimin në shkollë por edhe për të vazhduar procesin e zhvillimit digjital që u nis gjatë karantinës. Këto procese nuk mund të kuptohet pa bashkëpunimin e ngushtë me aktorët kryesorë të AFP që në kontekstin shqiptar përfshijnë:

Mësuesit

- Nxënësit
- Drejtoritë e shkollave profesionale
- Prindërit dhe kujdestarët
- Agjensitë përgjegjëse për AFP
- Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave
- Ministrinë e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë
- Komunitetin e donatorëve
- Bizneset dhe partnerët e praktikave profesionale
- Publikun e gjerë.

Çdo proces politikë-bërës dhe zhvillimi në arsimin profesional duhet të ndërthurë interesat e të gjithë këtyre grupeve sepse gjatë karantinës ishte bashkëpunimi i arritur mes të gjitha palëve i lartuar në solidaritet që siguroi vijimësinë e procesit shkollor që u evidentua gjatë mësimit në distancë. Ky bashkëpunim do të bindë politikë-bërësit qendrorë për nevojën e menjëhershme për investime të forta dhe afatgjata në infrastrukturën e shkollave dhe rritjen e përshkueshmërisë së internetit në të gjithë vendin.

IV. Analiza e gjetjeve

a. Analizë situacionale e AFP-së pas efekteve të mësimit në distancë

Mësuesit kanë mbajtur peshën kryesore të procesit mësimor nga distanca me një përgjegjësi të shtuar në shumicën e rasteve krahasuar me mësimin në klasë. Situata aktuale COVID-19 ka ndihmuar shumë mësues të bëhen më krijues, të përgjegjshëm dhe të përkushtuar por ka treguar edhe problemet si me mbështetjen institucionale dhe me përdorimin e metodave digjitale të mësimdhënies. Mbetet e rëndësishme dhe vlen të theksohet që mësuesit duhet të jenë më fleksibël e pranues kundrejt përdorimit të metodave të reja të mësimdhënies dhe krijimit të materiale të reja duke i rritur mundësitë që ata të përshtaten më shpejt me ndryshimet e të ecin në një rend me zhvillimet digjitale në arsim. Pjesa më e madhe e mësuesve u trajnuan dhe kërkojnë të aftësohen më tej për të zhvilluar materiale mësimore për mësim digjital. Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë si edhe projekti S4J ofruan trajnime dhe mbështetje teknike të vazhdueshme për të bërë të mundur zhvillimin e materialeve mësimore që fillimisht shpërndareshin përmes aplikacionit “WhatsApp” dhe më pas e gjithnjë e më profesionalisht përmes platformave digjitale të mësimdhënies.

Situata që u kalua por edhe trajnimet e ofruara për mësuesit theksuan rolin e mësuesve si moderatorë dhe organizues të proceseve të mësimit nga distanca dhe atij bazuar në platforma digjitale. Tani është e qartë që ka ardhur koha për të menduar në shqip për rëndësinë e pedagogjisë së trajnimit nga distanca dhe të bazuar në burimet e internetit e platforma si edhe format më të mira të ofrimit të saj pa shumë kosto e shpenzime për mësuesit. Në këtë kuadër ajo që është vënë re lidhet me rëndësinë që ka marrë mësimi i bazuar në shkëmbimet koleg – koleg dhe një lloj kaskadimi i procesit të të nxënit nga ata që kanë marrë pjesë në trajnime te ata që nuk patën mundësi të merrnin pjesë.

Procesi i bërjes së mësimit nga distanca dhe bazuar në platforma digjitale e komunikim përmes *WhatsApp* është shoqëruar me kosto domethënëse financiare për mësuesit. Atyre i është dashur të përballojnë kostot e azhurnimit të pajisjeve të tyre personale kompjuterike (TIK), pajisjeve celulare të zgjuara për të përballuar komunikimin masiv në WhatsApp dhe bërjen e video-shpjegimeve si edhe rritjen e bandës së internetit për t'i lejuar ata të ofrojnë programin mësimor dhe menaxhojnë procesin nga vendbanimet e tyre.

Mësimi në distancë apo edhe ai me metoda të kombinuara siç pritet të ndodhë në këtë vit shkollor kërkon nivele të reja motivimi dhe vetë-disiplinimi për të përballuar situatën mësimore të krijuar dhe për të shënuar nivele të reja zhvillimi në të mësuarin digjital i cili nuk mund të kuptohet apo funksionojë pa angazhim e bashkëpunim të fortë nga mësuesit dhe nxënësit. Komunikimi dhe angazhimi i vazhdueshëm me nxënësit janë të rëndësishëm për të shmangur braktisjen e shkollës dhe kjo merr një rëndësi specifike në kushtet e vështira social-ekonomike që kalojnë apo pritet të kalojnë një pjesë e mirë e nxënësve. Ashtu si edhe mësuesit, nxënësit tashmë kanë arritur të identifikojnë dhe njohin ndryshimet në rezultatet e të nxënit midis mësimit ballë për ballë dhe mësimit nga distanca.

Dihet që **nxënësit** nuk jetojnë në vakum dhe situata e karantinës i ka rritur edhe sfidat e bashkëjetesës. Mbetet shumë e rëndësishme që të kuptohen shkaqet të cilat sjellin mungesë performance nga ana e nxënësve që mund të lidhen edhe me çështje familjare, dhunë, apo fenomene të tjera psiko-sociale. Është vënë re që komunikimi online e lehtëson procesin e hapjes së nxënësve për këto probleme por si mësuesit dhe psikologët duhen trajnuar për të përballuar dhe menaxhuar më mirë procese të tilla nga distanca.

Pikë e dobët por edhe shumë e rëndësishme mbeten nxënësit me rezultate të dobëta dhe ata që nuk patën mundësi të angazhohen në proceset e mësimit nga distanca. Të drejtat e tyre për arsim dhe barazi në arsim janë shkelur. Gjatë procesit të zhvillimit të arsimit në distancë mësuesit dhe drejtoritë e shkollave janë përpjekur të mbajnë dokumentacion të plotë në lidhje me këtë gjë. Bazuar në këto të dhëna janë ndërtuar edhe programet e parapërgatitjes për vitin e ri akademik të cilat i japin mundësi nxënësve që nuk patën mundësi të ndjekin mësimin nga distanca por edhe të tjerëve për të rifreskuar njohuritë e marra. Në të njëjtin kuadër e përmes të njëjtit proces po procedohet edhe me praktikatat profesionale.

Pajisjet e komunikimit dhe kompjuterike luajtën një rol të rëndësishëm në mësimin nga distanca por ato duhet zgjedhur dhe zhvilluar më tej. Platforma MësoVET ka nevojë për më shumë burime, udhëzime dhe rritje të përdorimit në platformat celulare. Kjo platformë përbën edhe mundësi të mirë për të zhvilluar formatet e përziera të mësimit në AFP. Hulumtimi i teknikave të reja është i domosdoshëm për të siguruar vazhdimësi të proceseve të nisura gjatë mësimit në distancë.

b. Analizë situacionale në 10 shkolla AFP, partnere të projektit S4J

Marrëdhënia mësues – nxënës gjatë mësimit në distancë

Procesi i mësim-nxënies bazohet në shkëmbimin që ndodh gjatë orës së mësimit por edhe gjatë orëve të praktikës. Ndërveprimi mes mësuesve dhe nxënësve bëhet edhe më i rëndësishëm në arsimin profesional sepse përmes këtij ndërveprimi, këshillimit të ofruar dhe të mësuarit përmes vënies në praktikë të njohurive të marra realizohet të mësuarit aftësues për profesione të caktuara. Kjo marrëdhënie gjatë mësimit në distancë u kushtëzua nga vullneti i nxënësve për t'u angazhuar në mësim si edhe baza teknologjike në dispozicion të mësuesve dhe nxënësve për të realizuar mësimin. Në shkollat e përfshira në këtë studim si ora mësimore dhe shpjegimi i lëndëve u lidhën me platformën e komunikimit social *WhatsApp* duke qenë se kjo platformë u këshillua nga MASR bazuar në popullaritetin e saj në komunikim dhe lehtësitë që ajo ka për shpërndarjen e mesazheve dhe dokumenteve në grupe.

Mundësia e paktë për angazhim të drejtpërdrejtë në *WhatsApp* bëri që mësuesit në bashkëpunim me nxënësit të kalojnë procesin e orës së mësimit në platformat digjitale të kryesuara nga MësoVET. Me anë të grupeve *WhatsApp* realizohen proceset administrative si prezenca në orën e mësimit, lajmërimet e ndryshme, shpërndarja dhe dorëzimi i detyrave, apo edhe shpërndarja e videove shpjeguese apo dokumenteve përmbledhëse për mësimet.

Procesi substancial i shpjegimit ndërkohë duhet se kalon në platformat digjitale veçanërisht për lëndët me karakter teknik dhe profesional.

Përveç platformës MësoVET, mësuesit përdorin *Google Classroom* dhe *Cisco Net Academy* për lëndët profesionale në TIK. Platforma e komunikimit Zoom pati një përdorim të madh po ashtu. Ajo është përdorur dhe përfaqëson një pjesë të mirë të ndërveprimit sinkron. Një pjesë e mësuesve kanë zgjedhur që të përdorin edhe *Facebook* për të postuar materiale që ata vetë apo kolegët e tyre kanë përgatitur për orën mësimore dhe e organizojnë mësimin duke i lejuar qasje nxënësve në këto dokumente. Ajo që vihet re si nga mësuesit dhe nxënësit është një përpjekje e madhe për t'iu përshtatur situatës së mësimin në distancë duke përdorur të gjitha mundësitë për t'iu afruar sa më shumë mësimin në kushtet e klasës apo laboratorit.

Ndërveprimi virtual mes dy palëve synon të mbetet i drejtpërdrejtë por bazohet në shpërndarje informacioni përmes mesazheve, komunikimit në platforma dhe grupe dhe më pak përmes postës elektronike. Procesi i fotografimit është kyç për shpërndarjen dhe vlerësimin për detyrat. Nxënësit përmes *WhatsApp* marrin foto apo video të detyrave dhe dokumente që mund të shkarkohen dhe po me anë të *WhatsApp* ata duhet t'i dërgojnë mësuesve imazhin e detyrës që kanë bërë apo videon e procesit praktik që kanë kryer në kushtet e shtëpisë. Ky proces dhe ngarkesa e madhe e pajisjeve telefonike me imazhe e dokumente i ka bërë mësuesit që në pajisjet e tyre kompjuterike të shkarkojnë imazhet, videot dhe dokumentet e marra sepse pajisjet celulare kanë kapacitete të kufizuara mbajtëse. Krijimi i bazës evidentare bazuar në elemente si fotot, videot apo dokumente të punuara me kompjuter e të pranuar me anë të emailit përbëjnë bazën e ndërtimit, kontrollimit dhe vlerësimit të dijes.


Siç është vënë re dhe kuptuar edhe globalisht mësimi në distancë bazuar në komunikim virtual të drejtpërdrejtë apo pasiv është aq i mirë sa cilësitë teknike të rrjeteve dhe pajisjeve që realizojnë komunikimin dhe mundësitë për të pasur qasje në to. Kufizimet teknike janë të mëdha e të kuptueshme dhe mësuesit kanë parasysh që komunikimi mësimor bazohet në pajisje celulare. Mjeti të cilin ata përpiqeshin t'ia kufizonin përdorimin nga ana e nxënësve gjatë mësimin në shkollë, klasa e laboratorë, u bë mjeti kryesor për realizimin e mësimin nga distanca. Ky transformim digjital e virtual i komunikimit e ka bërë procesin e mësimdhënies bazuar në to të jetë më i qartë dhe më i drejtpërdrejtë, më i përmbledhur si edhe më figurativ e videofonike. Mësuesit janë të detyruar që të përshtatin mësimdhënien duke u bazuar në mjetet e komunikimit që nxënësit dhe ata vetë kanë dispozicion dhe kjo ka sjellë që shpjegimi lëndor dhe detyrat të përcillen në atë formë që maksimizon përdorimin efektiv të pajisjeve për njësitë mësimore të shpërndara virtualisht. Mësuesit kanë mprehur gjatë kësaj kohe aftësitë e tyre për komunikim efektiv dhe efikas në një proces virtual mësimor të kufizuar si teknikisht ashtu edhe nga pikëpamja kohore.

Procesi i vlerësimit të nxënësve bazuar në komunikim virtual dhe nga distanca paraqet problematikën e fiktivitetit i cili duket të jetë masivisht shqetësues për mësuesit e angazhuar në mësimin nga distanca. Kopjimi masiv i detyrave dhe dërgimi i materialit të kopjuar me foto

i ka përballur mësuesit me gjetjen e formave dhe mjeteve për të komunikuar mbi këtë problem por edhe për ta shmangur atë. Përdorimi i pyetjeve frontale gjatë komunikimit online apo organizimi i testeve bazuar në platforma digjitale janë disa prej zgjedhjeve që kanë bërë mësuesit në këtë proces. Nxënësit shprehen se platformat digjitale i kanë krijuar atyre mundësitë për vet-testim e matje vetjake të nivelit të njohurive. Kalimi në kontrollin virtual të dijeve veçanërisht bazuar në kufizimet teknike për komunikim virtual e mësim në distancë mbeti një nga problemet kryesore. Gjëja më e rëndësishme për komunikimin gjatë mësimit në distancë ishte dhe mbetet mbajtja e nxënësve të angazhuar për të mos humbur dëshirën për mësim dhe për të evituar braktisjen e procesit mësimor.

Ndryshimet në shpjegimin e lëndëve – blended approaches

Vihet re një shkallë e lartë e përgjegjshmërisë si nga ana e nxënësve ashtu edhe mësuesve drejt procesit mësimor. Kjo përgjegjshmëri ka sjellë ndryshimin që vihet re në procesin e shpjegimit i cili në shkollat e përfshira në këtë projekt po ecën mbi bazat e metodave të përziera të mësimdhënies ku në procesin e shpjegimit kombinohen të paktën 2 forma të angazhimit në distancë dhe disa lloje të komunikimit për të realizuar procesin.



Prezantimi i temave, koncepteve dhe proceseve të reja në lëndët e arsimit profesional është sfidues veçanërisht në vitet e ulëta të këtij arsimit. Nëse nuk do të ekzistonte mbështetja teknologjike digjitale procesi i shpjegimit nuk do të mund të realizohej sepse pa një bazë të mirë teknologjike digjitale mund të mendohet vetëm përforcimi i njohurive ekzistuese por jo prezantimi dhe shpjegimi i njohurive të reja. Kjo konfirmohet qartë nga nxënësit të cilët në gati 30% edhe kur i kanë mundësitë për t'u angazhuar me mësimin në distancë nuk arrijnë të kuptojnë konceptet apo temat e shpjeguara.

Praktikat profesionale

Dallimi thelbësor i arsimit profesional nga ai i përgjithshëm ka të bëjë me praktikat profesionale në njërin anë dhe përgatitjen e popullatës së nxënësve me kompetenca për t'u angazhuar e mbijetuar profesionalisht në tregun e punës. Mësimi në distancë dhe në kushte izolimi e kufizon parimisht këtë mundësi sepse nxënësit nuk kanë mundësi të ndjekin praktikat profesionale nëpër biznese apo të mësojnë e demonstrojnë praktikisht njohuritë e marra. Ndryshimi që u vu re në organizmin e praktikave mësimore nga distanca është:

- Strukturor – baza e praktikës është shikimi i videove, puna me dokumente dhe materiale që gjenden në shtëpi;
- Teknik – proceset paraqiten dhe mësohen nga distanca duke përdorur mundësitë e dhëna nga platformat digjitale apo mjete të tjera rrethore në shtëpi;
- Substancial – si edhe me mësimin teorik, qëllimi mbetet angazhimi dhe bërja e përpjekjeve maksimale në kushtet e kufizuara por pa pretenduar zhvillimin e kompetencave të cilat maten dhe provohen në realitetet industriale apo teknike
- Formativ - një pjesë e mirë e praktikave veçanërisht në drejtimet që lidhen me ekonominë, biznesin apo mirëqenien, kanë kaluar në formatin e projekteve virtuale që ndiqen nga distanca.

Procesi i bërjes së praktikës duket ra edhe në formalitet sepse një pjesë e konsiderueshme e nxënësve shprehen se praktika po bëhet si lëndët teorike. Edhe pse procesi i praktikës profesionale po realizohet ai mbetet një proces i vështirë për t'u kryer bazuar veçanërisht në shkëmbimin e videove apo fotove përmes *WhatsApp*.

Rregullat administrative dhe teknologjitë

Mbajtja e një celulari hapur gjatë orës së mësimi apo bërja e detyrave duke përdorur burime të gatshme në internet përpara situatës së pandemisë dhe gjatë zhvillimit të rregullt të shkollës ishin veprime që nuk lejoheshin. Në situatën e mësimi në distancë, komunikimi në distancë dhe qasja në dokumentacionin e lidhur me mësimin u mbështet në aparatet telefonike celulare. Rregulloret arsimore që rregullojnë arsimin në distancë kanë pasqyruar ndryshimet e ndodhura dhe amenduar mënyrën se si regjistrohet prezenca e nxënësve, si realizohen proceset mësimore, vlerësimi dhe matja e njohurive të marra. Këto ndryshime kanë hapur rrugën për të rishikuar rregullimin e procesin mësimor dhe kombinuar të mësuarin në klasë e gjatë orës së mësimi me format të tjera të mësimdhënies bazuar të teknologjitë digjitale e platforma online për mësimin. Mësimi i bazuar në metoda të përziera: njohuria teorike, praktika profesionale dhe mësimi digjital e në distancë duket se janë bërë pjesë e realitetit që do të shoqërojë arsimin profesional pas situatës së pandemisë COVID-19.

c. Analizë situacionale bazuar në pikëpamjet e drejtuesve të shkollave dhe përfaqësuesve të institucioneve drejtuese

Të gjendur përballë një situatë të papritur drejtuesit e shkollave dhe përfaqësuesit e institucioneve drejtuese e vlerësojnë pozitivisht aftësinë e shkollës së tyre për tu organizuar shpejt me grupe WhatsApp dhe Viber me qëllim krijimin e kontakteve të menjëhershme me nxënësit dhe mësuesit.

Shkollat ju përgjigjen shpejt kërkesës së MASR dhe nevojës për të zhvilluar mësimin online kryesisht nëpërmjet platformës së komunikimit Whatsapp dhe në ndonjë rast edhe viber. Në ndonjë rast shkollat hartuan edhe rregulloret e brendshme për raportimin duke ndarë detyra dhe përgjegjësi.

Drejtuesit vlerësuan në mënyrë të veçantë përpjekjet e mësuesve jo vetëm për të bërë më të mirën për realizimin e mësimit por edhe për mbështetjen ndaj nxënësve dhe për t'ju përgjigjur kërkesave për realizimin e mësimit.

Bashkëpunimi i ngushtë, ose si e kanë shpjeguar drejtuesit, elementi njerëzor i bashkëpunimit, ka qenë energjia kryesore e mbarëvajtjes së procesit mësimor. Mësues dhe nxënës bashkëpunues jo vetëm për realizimin e procesit por edhe për mbështetjen e kolegëve dhe nxënësve në vështirësi.

Shkollat partnere të projektit në fazën e parë të tij e patën më të lehtë të përballeshin me mësimin në distance për shkak se ishin trajnuar paraprakisht, një pjesë kishin filluar të përdorinin MësoVET dhe nxënësit ishin ambjentuar me platformën.

“Të papërgatitur, por punët u kryen shumë shpejt. Edhe ne krijuam grupet e klasave në Whatsapp. U hartua një rregullore e brendshme se si do të bëhej raportimi. U caktuan detyrat për drejtorin e nëndrejtorit dhe mësuesit. Fryma e grupit ishte shumë bashkëpunuese. Nxënësit nga shkollat rurale kishin vështirësi, dhe ne ju dhamë tabletat dhe laptopët e shkollës në rreth 95% ishin prezent.

Kjo dukej nga raportimi i përditshëm që mësuesit bënë tek nëndrejtorët. Në fillim ishte e vështirë, mësuesit bënë oferta nxënësve, kush kishte dy celularë jua dhamë nxënësve. Pak nxënës kemi nga Gramshi fshatrat e Tepelenës. Me 7-8 nxënës nuk arritëm të kishim komunikim”, thotë Shpresa Saliasi, Drejtoreshë e Shkollës Tregtare Vlorë.

Nevoja për të standartizuar mënyrën e realizimit të mësimit në distancë të paktën në nivel shkolle është e rëndësishme pasi ndikon në krijimin e një sistemi të unifikuar i cili mund të monitorohet me lehtësi, mësuesit mund të trajniten lehtësisht për këtë sistem dhe nxënësit kanë mundësinë të përshtaten shpejt me një sistem dhe të përqëndrohen në procesin e të mësuarit. Përdorimi i një sistemi të unifikuar i vendos edhe mësuesit përballë një standardi të barabartë pavarësisht nivelit individual të përkushtimit apo kushteve infrastrukturore.

Zëvendësministrja e MInistrisë së Financave (Sorensen) gjithashtu ka vlerësuar pozitivisht angazhimin maksimal të shkollave për tu përballur me ndryshimin e menjëhershëm në mënyrën e organizimit të mësimit. Krahasuar me kushtet rezultatet kanë qenë shumë pozitive por ndonjëherë më optimiste se duhet në raport me realitetin. Gjithsesi studime nga institucione të ndryshme kanë një lloj përputhshmërie në gjetje që mbështet fatin që shkollat kanë dalë përtej mundësive të tyre dhe kanë arritur rezultate impresionuese duke konsideruar kufizimet e mëdha që kanë pasur. Përdorimi i platformave digjitale për mësimdhënien ka qenë i kufizuar për shkak të mungesave infrastrukturore si edhe ëpr shkak të aftësive të kufizuara të mësuesve për të përdorur teknologji të avancuaranë realizimin e mësimit.

“Pandemia COVID - 19 na tregoi që reformat që kanë mbetur pezull tani bëhen më të nevojshme dhe të domosdoshme”, thotë Znj. Sorensen

Mësimi online tregoi që nga pikëpamja e mendësisë janë pjekur kushtet që shkollat të zhvillojnë mësimin në distance. Mësuesit, nxënësit në takimet e mëparshme me ta por edhe drejtuesit e shkollave dhe përfaqësuesit e institucioneve drejtuese u shprehën se realizimi i mësimit në distancë online është i mundur të realizohet dhe të përmirësojë më tej mënyrën e ofrimit të mësimit në rast se plotësohen kushtet e nevojshme infrastrukturore. Mësimdhënia digjitale jo vetëm që pasuron mënyrën e mësimdhënies, vjen më afër mendësisë së nxënësve të lindur dhe rritur në epokën e teknologjisë së informacionit, por edhe ju zhvillon atyre aftësi të nevojshme për tregun e punës sot dhe i përgatit për të ardhmen.

Sfidat

Mësimi në distance online në AFP shoqërohet me disa sfida. Sfidat me të cilat janë përballur gjatë semestrit të dytë të vitit mësimor të kaluar janë aktuale edhe për këtë vit mësimor duke qenë se pak ose aspak ka ndryshuar në organizimin e procesit mësimor gjatë këtij viti mësimor dhe në investimet e nevojshme për të përballuar nevojat dhe kërkesat që ka mësimi në AFP.

Pjesëmarrja

Nxënësit në zonat rurale kanë vështirësi për tu angazhuar në procesin mësimor në distance - online. Drejtuesit përmendën angazhim të nxënësve në mësim gjatë vitit të kaluar në masën

80-90% megjithatë sipas tyre edhe kjo shifër duhet të merret me rezerva, pasi nuk ka diferencime mes atyre që frekuentojnë pak dhe atyre që nuk frekuentojnë aspak. Ndërkohë edhe për shkak të sistemit të ngurtë të monitorimit dhe raportimit shifrat jo gjithmonë tregojnë realitetin. Duke qenë nën presionin e realizimit të mësimit, pavarësisht nevojave, shpesh raportimet bëhen me nota positive duke zbehur sfidat e vërteta të angazhimit të nxënësve.

Platforma

Në mënyrë unanime, mësuesit, nxënësit dhe drejtuesit u shprehën se mësimdhënia nëpërmjet Whatsapp nuk është një metodologji që të çon drejt mësimdhënies cilësore dhe brenda standarteve. Platforma e komunikimit Whatsapp ishte mundësia e vetme që ata të gjithë mësuesit kishin për të realizuar mësimin në kushtet e karantinës së plotë. Përdorimi i një platforme digjitale për mësimdhënien është e domosdoshme jo vetëm për realizimin e mësimit nga distanca por edhe pas situates së krizës. Ekzistenca e një platforme ku gjenden të organizuara lëndët dhe modulet për nxënësit, që krijon mundësi bashkëpunimi mes mësuesve dhe standartizon mënyrën e ofrimit të mësimit është një investim që e përfron mësimdhënien në AFP në Shqipëri me zhvillimet teknologjike dhe me mënyrën e realizimit të mësimit në shkollat në vendet e zhvilluara. Përdorimi i platformës mësimore lehtëson monitorimin e procesit mësimor, zhvillon tek nxënësit aftësi të tjera të transferueshme, I vendos mësuesit në pozita pune dhe i nxjerr nga rutina. Mësuesit, nxënësit dhe drejtuesit u shprehën me nota positive për përdorimin e platformës MësoVet si e vetmja platformë në gjuhën shqipe e dedikuar për AFP.

Bashkëpunimi mes mësuesve

Në kushtet e kriterëve minimaliste për organizimin e mësimit, dashamirësia dhe ndërgjegjia e mësuesve luan rol të rëndësishëm në realizimin e mësimit. Gjatë takimeve u oërmendën raste të mësuesve që bënin maksimumin edhe me kushtet minimale por kishte mësues që bënin rezistencë të bënin më shumë se kërkesa minimale e MASR për të bërë mësimin nëpërmjet Whatsapp.

“Ka disa kolege që përpiqen shumë edhe kur nuk i kanë pajisjet dhe ka të tjerë që bëjnë minimumin”, thotë Anila Bani, Drejtoreshë e Shkollës Teknike Ekonomike Tiranë

“Problem janë edhe mësuesit që i bëjnë rezistencë ndryshimit. Jo vetëm që nuk nxiten vetë për të bërë më shumë dhe eksploruar mënyra alternative të realizimit të mësimit por nxisin negativisht dhe të tjerët duke prishur klimën e përgjithshme. Kishte mes tyre që mendonin se nëse kërkesa ishte të përdorej Whatsapp, nuk

ishte e nevojshme të bëhej më shumë se aq? (shkolla “Hamdi Bushati”)

Përcaktimi i kriterëve minimale për realizimin e mësimin dhe mungesa e orientimeve të qarta e lë realizimin e mësimin në dashamirësinë e mësuesve, kur në fakt garanti për cilësinë nuk duhet të jetë individit por sistemi.

Materialet mësimore

Mësimi në kushtet e pandemisë nxori në pah edhe nevojën për rishikimin e materialeve mësimore lidhur së paku me dy çështje kryesore:

- Nevoja për materiale mësimore digjitale me qëllim përdorimin e informacionit për arritjen e objektivave
- Nevoja për ristrukturim të materialeve mësimore që janë në përputhje me kompetencat dhe targetojnë zhvillimin e aftësive të nxënësve.

Edhe nga studimet e mëparshme të S4J lidhur me mësimdhënien gjatë pandemisë, ka dalë në pah nevoja për zhvillimin e materialeve mësimore për lëndët e ndryshme në arsimin profesional që shpesh mungojnë, por edhe për përditësimin e tyre me nevojat dhe kërkesat aktuale të tregut të punës.

Ky është një problem i veçantë për mësimdhënien në AFP dhe sidomos për modulet e praktikës profesionale që janë specifike dhe përgatitja e tyre kërkon angazhim të posaçëm.

Nevoja për trajnim

Mësuesit dhe drejtuesit e shkollave treguan se trajnimi përpara pandemisë i mësuesve nga S4J kishte pasur efekt mjaft pozitiv në zhvillimin e mësimin në distance online. Megjithatë ata, vlerësuan si tejet të rëndësishme trajnimin e mësuesve për mësimdhënien digjitale. Mësuesit kanë nevojë të trajnohen:

- lidhur me përdorimin e platformave digjitale, veçanërisht MësoVet, si e vetmja platformë e dedikuar ndaj mësimin në AFP në gjuhën shqipe;
- teknikave dhe platformave më të reja që mund të ndikojnë në rritjen e interaktivitetit;
- metodologji të mënyrës së organizimit të mësimin në distance online;
- teknikat e vlerësimit nëpërmjet platformave digjitale për mësimdhënien sinkron dhe asinkron;
- përgatitjen e materialeve mësimore të përshtatshme për mësimdhënien në distance online.

Udhëzimi dhe monitorimi

Udhëzimet e MASR duhet jo vetëm të jenë të qarta dhe në përputhje me specifikat e Arsimit profesional por duhet gjithashtu të përcaktojnë standarde të larta të mënyrës së ofrimit të mësimin në distance online duke mbatur në konsideratë specifikat e secilit nivel dhe tipologji arsimit.

Vendimet duhet të merren bazuar në të dhëna të sakta të mbledhura nga shkollat e cikleve dhe profileve të ndryshme, në rajonë të ndryshme gjeografike me infrastrukture të ndryshme etj.

Drejtuesit tërheqin vëmendjen edhe ndaj sistemit të monitorimit i cili e humbet funksionin e tij kur përdoret kryesisht për qëllime kontrolluese apo ndëshkuese. Kjo mënyrë monitorimi rrit fiktivitetin dhe e bën të vështirë marrjen e vendimeve bazuar në të dhëna.

“Monitorimet janë kryesisht të natyrës kontrolluese dhe ndëshkuese nga autoritetet drejtuese duhet më shumë bashkëpunim dhe më pak ndëshkim pasi jemi në situatë të jashtëzakonshme, në të kundërt do të kemi vetëm arritje në letër”, thotë Hedië Gjoni, Drejtoreshë e shkollës “Gjergj Canco”

Për drejtuesit e shkollave, institucionet e arsimit në nivel qendror si MASR dhe agjencitë shtetërore në varësi të saj kanë një rol thelbësor në organizimin e procesit mësimor. Udhëzimet uniformiste dhe të përgjithshme, ndonjëherë edhe kontradiktore, si ishte psh në rastin e mos marrjes parasysh të vlerësimit të nxënësve gjatë periudhës së pandemisë, ndikojnë drejtëpërdrejtë funksionimin e përditshëm të shkollave. Të gjithë drejtuesit u shprehën se edhe pse e kuptonin faktin që MASR u përpoq të merrte një vendim për të ruajtur vlerësimin e nxënësve dhe mirëqenien e tyre, vendimi për të mos marrë në konsideratë vlerësimin gjatë mësimin në karantinë pati disa pasoja.

- Zhvlerësoi përpjekjet dhe punën e mësuesve dhe nxënësve gjatë pandemisë
- Injoroi autoritetin e mësuesve për të vlerësuar nxënësit dhe i bëri të pavlefshme përpjekjet e tyre për ti vlerësuar nxënësit.
- I trajtoi në mënyrë të njëjtë si nxënësit që përpiqeshin edhe të tjerët
- Ndikoi në humbjen e interesit të nxënësve dhe mësuesve për tu angazhuar në process gjatë muajve maj- qershor. Kjo sjell shumë implikime në humbjen e një periudhe të konsiderueshme mësimi përnjë gjeneratë që pati pothuaj një vit të humbur, nëse konsiderojmë dhe periudhën e tërmetit.

“Ishte vendim i Ministrisë së Arsimit të mos konsideruar mësimin online në vlerësimin. Pyetja që më ka gozhduar ishte se pse ne punuam kaq shumë. Stafit ka punuar fort dhe në fund iu kërkua që të mos konsiderohej fare. Duhet të pyeteshin grupet e interesit dhe përvoja e të gjithëve 6 orë online me mësuesit. Lodhja jonë duhej konsideruar pasi ka

pasur nxënës që janë angazhuar më shumë gjatë mësimit online”, thotë Anila Bani, Drejtoreshë e Shkollës Teknike Ekonomike Tiranë

Pavarësisht faktit se në kushtet e pandemisë është e vështirë të kesh kohën e mjaftueshme për të marrë vendime gjerësisht të konsultuara, MASR duhet të gjejë mekanizmat e përshtatshëm për të garantuar marrjen e vendimeve nga poshtë lart. Duke përdorur teknologjinë marrja e mendimeve të mësuesve mund të ishte edhe më e lehtë (si psh nëpërmjet një sondazhi të thjeshtë në google form).

Vendimet dhe udhëzimet e MASR duhet të marrin në konsideratë specifikat e arsimit profesional në veçanti për shkak të natyrës specifike që ka arsimiti profesional i kombinuar me lëndë teorike dhe module praktike.

Praktika Profesionale

Për shkak të natyrës së tij, praktike të të mësuarit dhe zhvillimit të procesit mësimor në biznese e kompani, të mësuarit në arsimin profesional u ndikua dhe më shumë nga pandemia. Sipas OECD (2020³) këto vështirësi mund të përmbliken në dy faktorë:

1. Vështirësi për të organizuar praktikën profesionale në kompani e biznese, për të organizuar aktivitete, për të pasur pajisjet, mjetet e nevojshme, pamundësia për të përdorur, laboratorët etj, pamundësia për të udhëtuar nga një vend të tjetrit.
2. për shkak të mbylljes së bizneseve dhe vendosjes së rregullave të higjienës dhe distancimit social, mundësitë e nxënësve për të realizuar praktikën profesionale janë më të kufizuara.

Praktika profesionale është aktiviteti më i rëndësishëm i arsimit profesional. Pavarësisht kësaj AFP nuk është një tipologji që mund të grupohet e trajtohet në të njëjtën mënyrë. Brenda arsimit profesional ka një larmi të madhe profilesh dhe drejtimesh dhe zhvillimi i tyre është i lidhur ngushtë si me specifikat e këtij kualifikimi ashtu edhe me kontekstin, vendin ku ndodhet shkolla, përbërjes së nxënësve, zhvillimit të asaj tipologjie biznesi në zonën ku ndodhet shkolla etj. Në qytetet e mëdha është problematikë edhe distanca fizike nga subjekti ku kryhet praktika, pasi nxënësit kanë nevojë për transport dhe kjo rrit kostot e udhëtimit por edhe të trajnimit të nxënësve. Në ndonjë rast, si psh në fushën e teknologjisë së Informacionit (Shkolla Gjergji Canco) edhe kur burimet financiare janë të disponueshme nuk ka specialistë të kualifikuar për profilet apo drejtimet që shkollat ofrojnë.

³ <http://www.oecd.org/coronavirus/policy-responses/vet-in-a-time-of-crisis-building-foundations-for-resilient-vocational-education-and-training-systems-fff194c/#section-d1e51>

Nga fokus grupet me mësuesit, nxënësit dhe intervistat me drejtuesit e shkollave mund të idektifikohen disa çështje lidhur me praktikën profesionale gjatë pandemisë:

- Së pari mësuesit dhe nxënësit kanë raportuar se janë gjetur mënyra nga më të ndryshmet dhe krijueset për realizimin e praktikës profesionale. Megjithatë gjetja e mënyrave për realizimin e praktikës nuk është e njëjtë për të gjithë profilet e arsimit profesional. Drejtimet e profilet e teknologjisë së informacionit, ekonomisë, marketingut por edhe guzhinës e kanë pasur disi më të lehtë për të zhvilluar mënyra alternative për realizimin e orëve të praktikës profesionale. Profilet si servisi makinave shërbimet shëndetësore e kanë pasur më të vështirë. Ndaj nuk është e lehtë të unifikosh mendimet dhe përvojat e mësuesve e nxënësve lidhur me realizimin e orëve të praktikës.
- vlerësimi pozitiv i realizimit të orëve të praktikës është i tillë duke u mbështetur në bërjen e më të mirës së mundshme në mundësitë ekzistuese. Nuk ka pasur asnjë analizë bazuar në kompetenca lidhur me arritjen e tyre dhe zhvillimin e aftësive profesionale të nxënësve. Sipas mendimeve dhe opinionëve të mësuesve dhe drejtuesve ka pasur shumë mangësi në formimin e praktik e profesional të nxënësve.
- Realizimi i praktikës profesionale ka qenë një pike e dobët edhe përpara pandemisë sipas drejtuesve të shkollave. Jo të gjitha shkollat kanë pasur mundësi të kenë një rrjet të gjerë bashkëpunëtorësh për zhvillimin e praktikave profesionale. Drejtuesit e shkollave janë shprehur në intervista se realizimi i praktikës profesionale ka qenë problematik edhe përpara fillimit të pandemisë, kryesisht për shkak të një rrjeti të kufizuar bashkëpunëtorësh për realizimin e praktikës profesionale.

Drejtesit (si p.sh. në shkollën Hamdi Bushati) kishin filluar punën paraprakisht për zgjerimin e rrjetit të bashkëpunëtorëve nga fusha e biznesit me qëllim krijimin e një rrjeti më të gjerë bashkëpunëtorësh për kryerjen e praktikës profesionale.

Shkollat kanë gjithashtu nevojë të zhvillojnë protokolle të posaçme për realizimin e orëve të praktikës profesionale ku të mbahen parasysh:

- Rregullat specifike për higjenën dhe distancimin fizik sipas tipologjisë së aktivitetit profesional që nxënësit do të kryejnë dhe ambientit ku do të kryhet praktika
- Numrit të nxënësve dhe mënyrë së shpërndarjes së tyre që mund të kërkojë më shumë kohë dhe burime njerëzore
- Rikonceptimin e procesit duke u nisur nga kompetencat e domosdoshme që nxënësi duhet të arrijë dhe zhvillimin e orëve të praktikës duke synuar arritjen e këtyre kompetencave.

Bardh Dedgjonaj, Drejtor i shkollës “Kolin Gjoka”, thotë:

“Realisht nuk i kishim kushtet e nevojshme, por tre muajt e fundit të vitit shkollor praktika u realizua brenda mundësive që kishim.

Për shembull, mësuesit u dërgonin video nxënësve duke gatuar ose iu kërkonin nxënësve të gatuanin në shtëpi e të regjistronin veten, duke përdorur platformat e ndryshme që i kërkonin në Google. Nxënësit e drejtimit “Teknologji e Informacionit dhe Komunikimit” e bëjnë praktikën në shkollë, ndërsa ata të drejtimit “Shërbim Social dhe Shëndetësor” realizojnë vetëm një pjesë të orëve të praktikës. Në shkollë e kemi më të lehtë për të realizuar disa orë të praktikës, pasi mësuesit kanë pajisjet, si: matje tensioni, diabeti, krevatin, etj.

Nxënësit e drejtimit “Ekonomi-Biznes” edhe para pandemisë pjesën më të madhe të praktikave e kanë zhvilluar në shkollë. Katër vitet e fundit mësuesit e trajnuar kanë mundësi që 80% të aktivitetit praktik ta realizojnë në firma ushtrimore.

Për drejtimin “Teknologji Ushqimore” numri i regjistrimeve këtë vit është vetëm 27.

Gjithsej kemi pasur 146 regjistrime, ndërsa sivjet më pak, pasi jemi rreth i vogël dhe nxënësit vijnë nga qytetet e vogla. Konvikti është prishur për shkak të tërmetit, ndërkohë që frika nga pandemia kufizon transportin publik dhe dëshirën për të qendruar në konvikt. Fshati ka me pak rreziqe në këtë pikë.”

Ferik Koçi, Drejtor i shkollës “Kristo Isak”, thotë:

“Nxënësit janë përshtatur dhe kanë bërë më të mirën, por gjithsesi praktika nuk kryhet si më parë. Mësuesit kanë siguruar materiale me video dhe audio, por kjo është e pamjaftueshme.”

Infrastruktura

Infrastruktura e shkollës me pajisje digjitale dhe internet, edhe në rastin e shkollave më të pajisura nuk është e mjaftueshme për mësimin në distance online. Mësimi në distance online kërkon internet dhe pajisje individuale për nxënësit dhe mësuesit nga shtëpia.

Nga studimi i realizuar në fazën e dytë nga S4J, 80% e nxënësve e ndiqnin mësimin në distancë nëpërmjet telefonave celularë, 13% prej kompjuterit dhe 6% nuk kishin pajisje personale, ndërkohë që vetëm rreth gjysma e tyre, 49%, kanë qasje të pakufizuar në internet.

Situata është e ngjashme edhe për mësuesit, ku gjysma e tyre kanë përdorur telefonin për mësimin në distancë online dhe 48% kanë përdorur kompjuter. 69% e tyre kanë qasje në internet nëpërmjet një linje fikse.

Si edhe drejtuesit u shprehën përdorimi i teknologjisë së shkollës, përveç lap topëve, nuk mund të vinte në ndihmë të nxënësve në kushtet kur mësimi zhvillohet nga shtëpia. Edhe laboratorët e mësimin të kombinuar mund të përdoren në shkollë për mësuesit dhe nxënësit por nuk e lehtësojnë situatën në kushtet e mësimin në distancë.

Mësuesit kanë gjithashtu nevojë për përdorimin e një platforme të posaçme për realizimin e mësimin në distancë. Përdorimi i platformave të komunikimit si Whatsapp apo Viber është një mënyrë për të ruajtur komunikimin e vazhdueshëm me nxënësit, apo për procese specifike, si psh në rastin e dërgimit të videove apo fotove lidhur me realizimin e një testi/ detyre, por kurrsesi nuk mund të jetë mënyra kryesore e realizimit të mësimin.

Edhe mësuesit dhe nxënësit e shkollave partnere të projektit, treguan se me kalimin e kohës nevoja e përdorimit të platformave dhe teknikave digjitale u bë e domosdoshme. Vetëm brenda një muaji, nga mesi i muajit Mars 2020 deri në mes të muajit prill, përdorimi i platformave digjitale për realizimin e mësimin online, si: Mësovet, Google Classroom, Net Academy, u rrit.

Refiko Kello, Drejtoreshë e shkollës “Ali Myftiu”, thotë:

“Në shkollën time nuk ka pajisje. Në 2014 në varësi të MASR ka ardhur paketa e fundit e kompjuterave: 11 kompjutera për 900 nxënës. Dy-tre i morëm nëpër zyra për nevojat e stafit, ndërsa tek kabineti i informatikës ka vetëm 6 kompjutera shumë të vjetër që nuk arrijnë të mbulojnë as orët e informatikës. Në inventar kemi tre laptopë kemi që nuk punojnë; unë punoj me laptopin tim. Nga AKFPA kemi dërguar sot kërkesat për pajisje dhe shpresojmë që gjendja të ndryshojë në shator. 10% e nxënësve kishin vështirësi të komunikimit gjatë mësimin në distancë. Mësuesit, sidomos ata nga zonat rurale, nuk arrinin të lidheshin pasi nuk kishin internet ose kishin mungesë valësh në telefon. Përdorimi i pajisjeve ishte problem për të gjithë. Celularët na dolën jashtë përdorimit.”

Investimi në infrastrukture digjitale nuk mund të zgjidhet me investimet e donatorëve, por kërkon një mënyrë financimi që të garantojë qëndrueshmëri. Në shkollat e para partnere të projektit, një pjesë e pajisjeve kanë nevojë të rinovohen. Ndryshimet në platformat digjitale bashkëkohore kërkojnë edhe pajisje me parametra më të avancuar dhe rinovim të vazhdueshëm.

“Pajisjet kompjuterike në shkolla janë mesatarisht një kompjuter për 31 nxënës. Ka shkolla me 11 nxënës për kompjuter apo 55 për kompjuter dhe nevoja për pajisje të tjera varion shumë nga shkolla në shkollë”, thotë Znj. Sorensen.

Në arsimin profesional ka disa donatorë që investojnë dhe koordinimi i përpjekjeve të tyre është i domosdoshëm për të rritur impaktin dhe maksimizuar përfitimin nga investimet e bëra.

“Shkollat kanë nevojë për infrastrukturë digjitale dhe mësuesit kanë nevojë për aftësi digjitale. Nëse shkollat nuk kanë pajisjet, trajnimi nuk ka shumë vlerë. Mbi 60% e mësuesve përdorin celularin dhe ky është një problem. Investimi në infrastrukturë është gjëja e parë që kemi propozuar, por jemi të hapur për të mbështetur në çdo lloj mënyre”, thotë një përfaqësues i AKFPKA

V. Konkluzione

Në nivelin e mësuesve, përpjekjet duhet të përqendrohen para së gjithash në zhvillimin e ekspertizës së tyre në përdorimin e TIK për mësimdhënie, dhe përdorimin e mundësive dhe burimeve të disponueshme të trajnimit digjital. Mësuesit gjithashtu duhet të kërkojnë të mësojnë dhe të bashkëpunojnë me kolegët e tyre në këtë fushë. Gjetjet e TALIS sugjerojnë gjithashtu që më shumë theks duhet t'i kushtohet forcimit të komunikimit dhe zhvillimit të partneriteteve me prindërit në mënyrë që studentët të mbështeten më së miri në mjediset e mësimin në distancë.

Në nivelin e drejtuesve të shkollave, përpjekjet duhet të synojnë të sigurojnë që shkolla të jetë sa më e mundur që të mbyllet shkolla duke inkurajuar bashkëpunim dhe mësim bashkëmohatar mes mësuesve për t'u siguruar që të gjithë arsimtarët janë të gatshëm për episodet e ardhshme të mbylljes së shkollës. Ofrimi i mundësive bashkëpunuese të të mësuarit profesional brenda shkollës, shkëmbimi i strategjive premtuese të eksperimentuara gjatë valës së parë të mbylljes së shkollës dhe inkurajimi i mësuesve të rimendojnë kolektivisht praktikën e tyre në realitetin e ri mund të ofrojnë një mekanizëm efektiv për të përgatitur komunitetin e shkollës për shpërthime të ardhshme. Përpjekjet duhet të përqendrohen gjithashtu në adresimin e çështjeve të burimeve që pengojnë përdorimin e teknologjive digjitale brenda shkollës kudo që të jetë kjo çështje.

Në nivelin e sistemit, përpjekjet duhet të përqendrohen në zhvillimin e mundësive të trajnimit - përfshirë mundësitë virtuale të të mësuarit - që mësuesit të zhvillojnë dhe forcojnë ekspertizën e tyre në mësimdhënien dhe vlerësimin e studentëve në distancë, dhe në përdorimin e TIK dhe teknologjive digjitale në mësimdhënien e tyre. Autoritetet e arsimit gjithashtu mund të hartojnë, kurojnë dhe të bëjnë të disponueshme burime të dobishme të përmbajtjes që mësuesit, studentët dhe prindërit e tyre mund të përdorin në rast të mbylljeve të mëtejshme të shkollës, si dhe platforma virtuale që lejojnë mësuesit të shkëmbejnë praktikën më të mira. Politika duhet të synojë mbështetje, siç janë programet kapëse, për studentët e pafavorizuar, të cilët janë prekur veçanërisht nga vala e parë e mbylljes së shkollës, si dhe për ata që do të duhet të qëndrojnë larg shkollës në planin afatgjatë për shkak të kushteve mjekësore në familjet e tyre. Për këtë grup të fundit, zhvillimi i provës për mësimin në distancë që përfshin ndërveprime të rregullta virtuale me mësuesit dhe nxënësit e bashkëmohatarëve do të dukej veçanërisht e rëndësishme për të mbështetur bashkëveprimet shoqërore të studentëve dhe zhvillimin e tyre njohës dhe social-emocional, pavarësisht nga një kontekst i izolimit të zgjatur.

Rëndësia e profesionalizmit të mësuesve

Mungesa serioze e ndërlidhjes dhe aftësive digjitale midis mësuesve si dhe nxënësve duhet të adresohet për të siguruar përgatitje efektive të sistemeve të trajnimit. Duhet të vendoset korniza ligjore për të mbështetur fleksibilitetin e të mësuarit dhe të mësimdhënies. Përvoja

në mësimin në distancë si nga mësuesit dhe nxënësit në kontekstin e COVID-19 duhet të regjistrohet dhe përpunohet mirë për të shërbyer për t'u përgatitur për krizat në të ardhmen. Për mësuesit, trajnimi digjital përkatës duhet të përfshihet në programet e tyre të trajnimit të vazhdueshëm. Mësimi në internet duhet të merret parasysh në zhvillimin e kurrikulës / trajnimit modular.

- Përshtatja me një kontekst të ripërshtaten me një kontekst dhe ritëm të ri;
- Marrja përsipër e përgjegjësive të rritura për të siguruar mësimdhënien nga distanca dhe me pajisje digjitale;
- Rishikimi i elementeve kryesore të trajnimit të vazhdueshëm profesional:
 - Aksesimi në infrastrukturë;
 - Platforma online / offline të përshtatura për nevojat e trajnimit;
 - Burimet e adaptuara pedagogjike për mësimin në distancë;
 - Parashikimi dhe menaxhimi i krizës;
 - Gatishmëria për mbështetja e nxënësve.
- Mirëqenia e mësuesve dhe vazhdimi i profesionit në planin afatgjatë.

Komunitete të forta dhe me përgjegjësi shkollore

Shkollat do të duhet të përqëndrohen, së bashku me familjet dhe komunitetin e gjerë, në tre fusha thelbësore, ndërsa ata ecin përpara: 1) forcimin e sigurisë dhe besimit; 2) sigurimin e mirëqenies së nxënësve dhe vazhdimësinë e mësimin; dhe 3) ndërtimi i rezistencës përmes reflektimit kolektiv, bashkëpunimit të zgjeruar dhe udhëheqjes së shpërndarë.

Higjiena, distanca sociale dhe komunikimi janë masa të domosdoshme për të ushtruar sigurinë shëndetsore gjatë rihapjes së shkollave. Masat përfshijnë pastrimin dhe dezinfektimin e infrastrukturës fizike (CDC, 2020), praktikat e higjienës përforcuese siç janë larja e duarve dhe etiketa e teshtitjes; dhe mësimin dhe zbatimin e masave për distancimin shoqëror brenda shkollës (UNICEF, WHO, IFRC, 2020; Uscher-Pines et al., 2018).

Komunikimi transparent dhe në kohë me komunitetin e shkollës më të gjerë është thelbësor. Prindërit kanë nevojë për informacion në lidhje me datën e rihapjes, planin kohor për javët e para, masat e reja të sigurisë dhe higjienës dhe shërbime për të mbështetur fëmijët dhe prindërit.

Ndërtimi i qëndrueshmërisë: Bashkëpunimi i forcuar dhe udhëheqja e shpërndarë

Ndërsa kriza vazhdon, përgjegjësia e përbashkët brenda shkollave dhe ndërmjet shkollave dhe komunitetit më të gjerë mund të ndihmojë shërbimet arsimore të veprojnë në sa më shumë fronte. Këto përfshijnë masa paraprake shëndetësore, kërkesa të jashtëzakonshme për stafin dhe buxhetet dhe rregullimet në kurrikul dhe metodat e vlerësimit. Përgatitja për mbyllje të mundshme në të ardhmen ndërsa adresoni urgjencat aktuale kërkon udhëheqje të

qartë, si dhe përshtatje, koordinim dhe besim. Vendim-marrja e përbashkët ishte tashmë e pranishme në shumë shkolla para krizës.

Drejt së ardhmes: Ndërtimi i sistemeve dhe shkollave elastike

Shkollat në të gjithë botën po i kthehen punës, por jo në normalitet. Masat e rrepta të higjienës dhe distancimit shoqëror tani janë norma e re.

Përveç hapave të menjëhershëm për rihapjen e shkollave, arsimi gjithashtu duhet të fillojë përgatitjen për valët e ardhshme të mundshme të ngjitjes dhe mbylljen e shkollave. Ne duhet të mësojmë nga ajo që po testohet tani, dhe gjithashtu ta përdorim këtë kohë si dritare të mundësive për të rimenduar dhe rivarruar sistemet tona. Për riorganizimin e mësimin dhe vlerësimin për t'i shërbyer nevojave të të gjithë studentëve, përfshirë edhe ata më të prekurit. Për forcimin e rrjeteve që mësuesit të vazhdojnë të ndërtojnë njohuritë dhe aftësinë e tyre si ndërrues të lojërave. Për forcimin e bashkëpunimit për familjet, komunitetet dhe shkollat për të shkëmbyer informacione dhe koordinuar në mënyrë efektive. Iniciativat dhe investimet e bëra tani mund të kenë efekte pozitive afatgjata në sistemet tona arsimore dhe shoqërinë në përgjithësi.

Brezi I nxënësve në shkollat aktuale është ekspozuar ndaj mënyrave të përdorimit të teknologjisë që nga lindja dhe mënyra e tyre e të mësuarit lidhet edhe me përdorimin e teknologjisë⁴. Stujdues të ndryshëm (Geck, 2007, Cilliers, 2017, Mohr et. al, 2017, Ferdig et al, 2020) prej kohësh kanë filluar të flasin për nevojën e transformimit të procesit mësimor në përputhje me nevojat e gjeneratës së rritur në periudhën e teknologjisë së informacionit. Ka ardhur koha që komunikimi në klasë të zëvendësohet me ndërveprimin (Cilliers, 2017, fq. 193)

Në një studim të organizatës ndërkombëtare për bashkëpunim ekonomik dhe zhvillim (Maj, 2020)⁵ për arsimin profesional pas pandemisë identifikohen disa veprime konkrete të cilat duhen ndërmarrë sa më pare për të përafuar ofertën e AFP me ndryshimet në tregun e punës. Disa prej tyre janë:

Rritje e bashkëpunimit me punëdhënësit dhe bizneset. Gjatë pandemisë edhe bizneset janë ndikuar në mënyra të ndryshme dhe mund të dalin në pah edhe mënyra të reja bashkëpunimi të pamenduara më parë si video konferencat që rritin mundësinë e bashkëpunimit.

Planet e zhvillimit të shkollave në nivel kombëtar por edhe në nivel rajonal e shkolle duhet të bëhen bazuar në parashikimin e ndryshimeve të mundshme në tregun e punës. Për shkak të ndryshimeve teknologjike shumë profesione transformohen me shpejtësi, të reja bëhen të nevojshme dhe të tjera ristrukturohen apo zhduken.

⁴ <https://workplaceinsight.net/gen-z-are-technologically-literate-but-not-actually-robots-dell-study-confirms/>

⁵ Organisation for Economic Co-operation and Development (OECD). (2020). VET in a time of crisis: building foundations for resilient vocational education and training systems.

Mbështetje financiare për sistemin e arsimit profesional me qëllim kualifikimin dhe profilizimin e tyre në profesione që do të jenë të qëndrueshme edhe në të ardhmen dhe lidhen me zhvillimin ekonomik të vendit.

Eksplorim I mënyrave inovative të ofrimit të mësimin në distancë online duke kombinuar teknika e platforma të ndryshme si simuluesit, realiteti virtual, inteligjenca artificiale.

Investim në infrastrukturë digjitale për të rigjallëruar dhe ofertën e kualifikimit profesional. Krijimi I një sistemi të qëndrueshëm dhe me fleksibilitetin e nevojshëm për të financuar ndryshimet dhe zhvillimet infrastrukturore.

Programet e arsimit profesional duhet të ofrojnë mundësinë për mësimin dhe zhvillimin e aftësive thelbësore si digjitale, dhe aftësi bazë socio emocionale. Aftësi të tilla të transferueshme e bëjnë më të lehtë tranzicionin e kalimit nga një profesion në një tjetër, shumë e rëndësishme në periudhat e krizave.

Vëmendje e veçantë duhet treguar ndaj grupeve më të cënueshme të shoqërisë. Këta individë janë zakonisht edhe targeti kryesor i AFP dhe mund të vuajnë më shpesh mungesën e internetit, pajisjeve për mësim në distancë dhe preken më shumë jo vetëm nga situata e krizës që po kalojmë por edhe nga pasojat që ajo lë më pas.

Kualifikim i vazhdueshëm i mësuesve për të ofruar mësimdhënie cilësore të një niveli të lartë. Mësuesit e AFP duhet të kenë aftësi të zhvilluara të mësimdhënies digjitale në mënyrë që ti përcjellin ato aftësi nëpërmjet modelit të tyre të mësimdhënies. Kjo kërkon që mësuesit të trajnohen dhe zhvillohen në mënyrë të vazhdueshme.

VI. Rekomandime

Duke u nisur nga zhvillimet dhe analizat e bëra deri më tash e duke marrë në konsideratë vendimet që janë marrë dhe po merren në lidhje me arsimin dhe mësimdhënien në AFP periudha afatshkurtër 12 – 24 mujore duhet parë si një periudhë e cila krijon hapësirën e duhur për të rikonceptuar, ri-diskutuar dhe rilidhur sistemin AFP me aktorët dhe përfituesit e tij. Është çasti i duhur për të adresuar dobësitë sistemike që janë vënë re dhe për të riformuluar investimet në arsim, e veçanërisht në arsimin profesional. Në këtë drejtim të arsimit nevoja për investime digjitale dhe integrim edhe më të fortë të metodave të reja të mësimdhënies me ato ekzistuese janë shumë eminente.

Përdorimi i novacionit digjital në komunikim: siç u theksua disa herë në këtë studim shumë mësues dhe nxënës përdorën një shumëllojshmëri të mjeteve digjitale duke e adresuar në më shumë se një formë si mësimdhënien dhe mësim-nxënien. Ata arritën me sukses në raste të lëndëve të veçanta të angazhoheshin në mësim kolektiv dhe jo individual në klasa digjitale dhe forcuan marrëdhëniet e shkëmbimit të informacionit dhe kërkimit të ndihmës në baza virtuale. Suksesi i arritur duhet të jetë bazë për të kuptuar se çfarë u bë mirë dhe se si mund të shtrihet ajo në të gjithë sistemin kur mendojmë për novacionin digjital.

Nga ana tjetër bashkëpunimi i qëndrueshëm me AKAFPK bazuar në atë që është arritur deri më tash është një provë për të rishikuar mënyrat e organizimit dhe shpërndarjes së kurrikulës në arsimin profesional duke nxitur multi-disiplinartetin dhe bashkëpunimin ndër-lëndor kryesisht në mësimdhënie për të ndikuar dhe të mësuarin. Lidhja mes lëndëve profesionale dhe atyre të përgjithshme duhet rritur dhe kufiri mes tyre duhet të shkojë drejt shuarjes të paktën kur këto lëndë ofrohen në platforma digjitale e hibride.


Rikonceptimi i vlerësimit dhe llogaridhënies duhet të vijë si proces i natyrshëm pas situatave të krijuara nga pandemia ku në shumë vende të botës u anuluan provimet ose u vlerësuan me forma të thjeshta bazuar në kalim/mbetje. Novacioni në vlerësim dhe rikonceptimi i procesit të kontrollit të njohurive dhe llogaridhënies duhet të jenë hapi i radhës që duhet ndërmarrë në modernizimin digjital të mësimdhënies. Kjo kërkon një mendësi të re për vlerësimin dhe matjen e dijes, hapje dhe përqaftim të metodave të ndryshme të vlerësimit, mësim të tyre përmes trajnimeve certifikuese për të arritur në ri-dimensionimin e kornizave të vlerësimit dhe zgjerimin e të kuptuarit që ne kemi për sigurimin e cilësisë, matjes së saj dhe certifikimit përmes AFP-së.

Mësimi është dhe mbetet proces ndërveprues dhe fizik. Qenia njerëzore e ka të rëndësishme pjesën fizike dhe merr emocione të shëndetshme nga ndërveprimi fizik. Mësimi është proces që ndodh ballë për ballë si fizikisht ashtu edhe virtualisht. Drejtpeshimi mes formave “të vjetra/klasike” të mësimdhënies me mekanizmat e rinj digjitalë duhet menduar mirë për të hapur rrugën drejt një hibriditeti pedagogjik dhe mësimdhënie të kombinuar që rrit cilësinë

dhe efektivitetin në AFP. Nxënësit në AFP *lulëzojnë* profesionalisht, fizikisht, akademikisht dhe psikologjikisht kur ata janë në mjedisin e tyre të klasës ose të praktikës profesionale. *Brishtësia e të rinjve* që shihen si nxënës na u bë edhe më e qartë gjatë situatës së karantinës kur një pjesë e mirë e tyre nuk arritën të kyçen në arsimin nga distanca për shkak të kushteve të pafavorshme e varfërisë ekonomike. Arsimi ka dhe mbetet një politikë me fuqi barazuese e duhet të mbështesë të gjithë pjesëmarrësit në të.

Zhvillimi profesional i drejtuesve dhe mësuesve dhe rritja e kapaciteteve përforcuese për njohuritë që u ndërmorrën për të realizuar mësimin nga distanca kanë rëndësi të dorës së parë për ta bërë shekullin e 21 të ulet këmbëkryq në AFP. Shkollat duhet të hapen drejt komunitetit e ta lënë atë të marrë pjesë në proceset mësimore dhe profesionale duke shtuar gamën e partnerëve e duke ndërtuar koalicione që e kalojnë nivelin e familjeve të nxënësve. Proceset duhet të jenë strategjike dhe të krijojnë marrëdhënie që e kalojnë sfidën e krizave dhe emergjencave.

Qëndrueshmëria e sistemit bazuar në ndërtimin e përshtatshmërisë dhe reagueshmërisë mbetet sfidë për çdo politikë-bërje veçanërisht kur mungesat buxhetore në arsim janë bërë një fenomen i zakonshëm global. Koha kërkon njohuri dhe sjellje të reja nga *autoritetet arsimore, drejtuesit e shkollave, mësuesit, nxënësit dhe prindërit* për të përballuar situatat pandemike dhe emergjenca të tjera. Me afrimin e recesionit ekonomik për shkak të pandemisë COVID-19 afron edhe koha për zgjedhje të vështira përse i takon arsimin dhe buxhetit për arsimin profesional. Bashkëpunimi dhe angazhimi efektiv i donatorëve dhe biznesit mbeten thelbësor. Përzgjedhja e kompetencave që do i duhen dikujt për të hyrë rregullisht në tregun e punës dhe financimi i tyre janë çështje që tashmë janë shtruar për zgjidhje.



Swisscontact po siguron masa të ndryshme mbështetëse për mësuesit dhe trajnerët përmes trajnimeve në internet, punëtorive dhe seminareve. Këto synojnë të azhurnojnë aftësitë e TIK-ut të mësuesve dhe trajnerëve dhe të ndihmojnë në përgatitjen e materialeve e-mësimore. Masat mbështetëse gjithashtu synojnë të ndihmojnë në përgatitjen dhe shpërndarjen e seancave në internet, si dhe në përdorimin e platformave në internet.

Bazuar në gjetjet e këtij studimi disa rekomandime konkrete për zhvillimin e mësimit në distancë dhe integrimin e elementëve të mësimit digjital janë:

1. Vlerësim i kushteve infrastrukturore, pajisje kompjuterike dhe internet, dhe plotësimi i nevojave shtesë për mësuesit dhe veçanërisht për nxënësit më në nevojë.
2. Mbështetje infrastrukturore:
 - a. karta SIM falas për të gjithë mësuesit e sistemit profesional dhe kuponat për internetin për nxënësit
 - b. pajisja e mësuesve me laptopë dhe tableta;
 - c. investim në lidhjen me fibra optike;
 - d. gjetja e mënyrave për përballimin e kostove të lidhjes së internetit dhe abonimit të vazhdueshëm në të bazuar në statusin e mësuesit.
3. Trajnim i vazhdueshëm i mësuesve lidhur me aftësitë e tyre digjitale e teknologjike. Në kushtet e zhvillimeve të vrullshme digjitale përdorimi i tyre për procesin e mësimdhënies është i domosdoshëm për ta realizuar procesin mësimor në përputhje me zhvillimet aktuale.
4. Promovimi i mënyrave të reja të përdorshme në mësimdhënie si Pedagogjia e zhvillimit të materialeve në internet dhe mësimit bazuar në internet; Video-editimi dhe krijimi i mësimëve me bazë video; Podcaste me shpjegimin e temave të ndryshme të lëndës; Educational toolbox për mësuesit, etj.
5. Përgatitja e materialeve mësimore të përditësuara jo vetëm me aftësitë profesionale të nevojshme por edhe të formatuara sipas kërkesave të nevojshme për mësimdhënie në distancë online.
6. Fuqizimi i platformës Mësoret, kryesisht me materiale mësimore për të gjitha lëndët dhe modulet e profileve të arsimit profesional dhe trajnimi i mësuesve për përdorimin e tyre.
7. Zgjerimi i rrjetit të bashkëpunëtorëve për zhvillimin e praktikës profesionale.
8. Hartimi i kurrikulave në bashkëpunim të ngushtë me tregun e punës dhe përcaktimi i modaliteteve për përditësimin e shpeshtë të kurrikulës në përputhje me kompetencat e nevojshme në tregun e punës.
9. Rol më aktiv i institucioneve drejtuese me udhëzime të qarta, lidhur me:
 - a. Vlerësimin e platformave të nevojshme për tu përdorur në cikle dhe nivele të ndryshme të arsimit;
 - b. Orientime të qarta dhe vendime të konsultuara me grupe të ndryshme mësuesish e nxënësish, drejtuesit e shkollave, etj.;

- c. Vlerësimi i legjisllacionit lidhur me mësimdhënien online, mundësitë e ofrimit të mëimit sinkron dhe asinkron si për nënësit edhe për kualifikimin e mësuesve;
- d. Zgjerimi i ofertës së trajnimeve për mësuesit;
- e. Koordinimi i punës së donatorëve të ndryshëm që punojnë në fushën e arsimit profesional me qëllim maksimizimin e përfitimit nga puna dhe investimi i tyre;
- f. Identifikimi i burimeve për rritjen e investimeve në infrastrukture digjitale;
- g. Vlerësimi i mundësive dhe nevojave të nxënësve më në nevojë, që janë edhe ata që ndjekin më shumë arsimin profesional dhe mëshitetja e tyre.

Specifikisht për arsimin profesional

- h. Politika të dedikuara për AFP në kuadër të përgjigjeve për situatën mungojnë. Qeveritë e kanë vënë theksin më shumë te arsimi i përgjithshëm. S4j ka zhvilluar kurse online dhe ka fuqizuar më tej zhvillimin e platformës MësoVET.
- i. Zhvillimi i një platforme unike digjitale për të lehtësuar mësimin nga distanca dhe atë digjital.
- j. Ndhimë financiare kesh për të përballuar shpenzimet shkollore dhe ushqimore për familjet e varfra dhe që rrezikojnë të largojnë fëmijët nga shkollat prej mungesës së bursave apo mos funksionimit të konvikteve.
- k. Rritja e sigurisë në klasa dhe shkolla bazuar në raportimet e përditshme për gjendjen shëndetësore të nxënësve dhe ndjekjen e rregullave të caktuara. Investime të thjeshta për të rritur furnizimin me ujë dhe sapun për shkollat e nivelit para-universitar.
- l. Bërja e një procesi fizibiliteti për rritjen e përshkueshmërisë së internetit dhe rritjes së bandave digjitale në funksion të institucioneve arsimore krah për krah me rritjen e mundësive për akses në internet të familjeve që kanë fëmijë që ndjekin studimet në nivelin parauniversitar.
- m. Stimulimi financiar i mësuesve që përgatisin kurrikula për lëndë që zhvillohen në platforma digjitale dhe bazohen në mësimdhënie hibride.
- n. Procesi i kualifikimit profesional gjatë karrierës duhet përshtatur me modalitetet virtuale të dhënies së trajnimit dhe vlerësimit, duke rishikuar edhe proceset e kreditimit për të
- o. Zhvillimi i rregulloreve të qëndrueshme që lidhen me mësimin në distancë, digjital dhe të kombinuar
- p. Udhëzime në nivel drejtorie rajonale dhe shkolle apo grup shkollash në bazë të profilit.

VII. Bibliografi

Organisation for Economic Co-operation and Development (OECD). (2020). VET in a time of crisis: building foundations for resilient vocational education and training systems.

Cilliers, E. J. (2017). The challenge of teaching generation Z. *PEOPLE: International Journal of Social Sciences*, 3(1).

Geck, C. (2007). The generation Z connection: Teaching information literacy to the newest net generation. *Toward a 21st-century school library media program*, 235, 2007.

Ferdig, R. E., Baumgartner, E., Hartshorne, R., Kaplan-Rakowski, R., & Mouza, C. (2020). Teaching, technology, and teacher education during the covid-19 pandemic: Stories from the field. *Waynesville, NC, USA: Association for the Advancement of Computing in Education (AACE)*.

Mohr, Kathleen AJ, and Eric S. Mohr. "Understanding Generation Z students to promote a contemporary learning environment." *Journal on Empowering Teaching Excellence* 1, no. 1 (2017): 9.

<https://digitalcommons.usu.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=1005&context=jete>

OECD (2020), "How prepared are teachers and schools to face the changes to learning caused by the coronavirus pandemic?", *Teaching in Focus*, No. 32, OECD Publishing, Paris, <https://doi.org/10.1787/2fe27ad7-en>.